



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE  
BORDI**

**VENDIM**

**Nr. 152, datë 31.08.2023**

**PËR  
MIRATIMIN E SHOQËRIVE “RSM ALBANIA” SH.P.K., DHE “ALBANIAN AUDIT  
PARTNERS” SH.P.K., SI SHOQËRI AUDITUESE PËR AUDITIMIN E PASQYRAVE  
FINANCIARE TË SHOQËRISË ADMINISTRUESE “WVP FUND MANAGEMENT  
TIRANA” SH.A., SI DHE TË FONDEVE QË ADMINISTRohen PREJ SAJ,  
PËR VITIN FINANCIAR QË MBYLLET MË 31.12.2023**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 14, pika 5, të ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, si dhe nenit 35, të ligjit nr. 56, datë 30.04.2020 “Për sipërmarrjet e investimeve kolektive” dhe të rregullores nr. 89, datë 27.06.2016 “Për kriteret dhe kërkesat për miratimin e shoqërisë audituese të shoqërive administruese të sipërmarrjeve të investimeve kolektive dhe shoqërive administruese të fondeve të pensionit vullnetar”, e ndryshuar, Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

**V E N D O S I:**

- 1. Miratimin e shoqërive “RSM Albania” sh.p.k., dhe “Albanian Audit Partners” sh.p.k., si shoqëri audituese për auditimin e pasqyrave financiare të “WVP Fund Management Tirana” sh.a., si dhe të fondeve që administrohen prej saj, për vitin financiar që mbyllet më 31.12.2023.**
- 2. Ngarkohet Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut të Fondeve për njoftimin dhe ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.**

**Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.**

**KRYETAR  
Olsi ÇOKU**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV  
Ervin METE**